

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit tetor, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 6 mbledhje, që kanë rezultuar në 25 vendimmarrje, ndër të cilat:

- Licencimin e shoqërive "PARISOL" shpk dhe Albanian Power Core" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në Qarkun Fier, për një afat 25-vjeçar, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW për shoqërinë "PARISOL" shpk ushtrimi i veprimtarisë së cilës duhet të nisë jo më vonë se data 28.09.2025 dhe nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 40.56 MW për shoqërinë Albanian Power Core" shpk ushtrimi i veprimtarisë së cilës duhet të nisë jo më vonë se data 27.03.2027; si dhe të shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sha në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-pesë vjeçar.
- Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive:
 - "SLR ALBANIA" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2MW, me vendndodhje në qarkun Fier, për një afat 25 vjeçar.
 - "SPV BLUE 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik "Blue 2", me kapacitet të instaluar 50MW, me vendndodhje në qarkun Fier, për një afat 25 vjeçar.
 - "AXPO ALBANIA" sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
 - "DELTA PLAN STUDIO" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW secila, në Qarkun Fier.
 - "ORHER" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW secila, në Qarkun Fier.

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Rinovime të licencave

Tarifa dhe çmime

Plotësim të kushteve

Aktivitete

Platforma PCT

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Vendime të tjera mbi të licencuar apo subjekte që kanë nisur aplikimin për licencim:

a.Mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “TEODORI” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”.

b.Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesave të shoqërive si më poshtë:

a.Për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërive:

i.“Samasol” shpk;

ii.“Rebesol” shpk;

iii.“Zenina” shpk;

iv.“DRIBEN” shpk

c.Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” shpk.

d.Fillimin procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të asetëve të paluajtshme të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a.

e.Miratimin dokumentit të përbashkët të tre rregullatorëve të energjisë, ERE, ARERA dhe RAAEY: “Miratimi i një ndryshimi në Kodin e Rrjetit TAP dhe Kodin Tarifor të TAP, të propozuar nga TAP AG më datë 29 tetor 2024.

f.Fillimin e procedurës për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar.

Vendime të tjera mbi të licencuar apo subjekte që kanë nisur aplikimin për licencim:

- Pezullimin për 90 ditë të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi shqyrtimin e kërkesës e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për modifikimin e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 02.07.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, sipas përcaktimeve të të cilave shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike për kapacitetin e instaluar prej 25 MW me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve, si dhe ushtrimin e veprimtarisë së licencuar për kapacitetin e plotë prej 100 MW jo më vonë se data 11.01.2028.
- Rinovimin e licencës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh[erjola sa1] pk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 06.03.2025.
- Disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.01.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kW, i ndryshuar, duke vendosur kushte detyruese të reja për shoqërinë.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

ERE është përgjegjëse për zhvillimin e metodologjive të tarifave dhe çmimeve për aktivitetet e rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazuar në analizat e saj propozon përmirësime të metodologjive ekzistuese.

Sa i përket kësaj fushe përgjegjësie, gjatë muajit tetor janë marrë vendime mbi:

a. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 prej 16.86 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Për më shumë informacion në lidhje me cmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuara nga ERE gjatë vitit 2024, referojuni faqes së ERE, www.ere.gov.al

Gjatë muajit tetor janë zhvilluar 6 seanca dëgjimore, me konsumatorë por dhe të licencuar, me qëllim sqarimin e detajeve të nevojshme për zgjidhjen e ankesave përkatëse, apo vazhdimin e procesit të licencimit të subjektit në fjalë.

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me regjistrat e [licencimit të subjekteve](#), të [garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të rifreskuar, si dhe [tarifa dhe çmime](#) të miratuara nga ERE.

ERE ka nisur shqyrtimin e propozimeve për ndryshime të rregullat e tregut të energjisë elektrike. Gjithashtu ju ftojmë të shfletoni të dhënat e fundit të tregut të energjisë në vend, ku do të gjeni raporte periodike mbi monitorimin e tregut të energjisë dhe aktivitetin e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike për 9-mujorin e parë të vitit 2024 si dhe [të dhënat e tregut të energjisë për 9-mujorin e vitit 2024](#).

Workshopi Trilateral MEDREG - ECRB - CEER

Më datë 9 tetor 2024 në Lisbonë dhe online, u organizua Workshopi Trilateral i përvitshëm i MEDREG - Shoqata e Rregullatorëve të Mesdheut, nën mikëpritjen e Rregullatorit Portugez të Energjisë - ERSE. Ky workshop, i cili organizohet në bashkëpunim me Këshillin Evropian për Rregullatorët e Energjisë - CEER dhe Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë - ECRB, përbën një platformë të rëndësishme për shoqatat anëtare për të diskutuar dinamikat më të fundit në tregun e energjisë dhe ndikimin e tyre tek konsumatori përfundimtar. Tema kryesore e eksploruar ishte e ardhmja e tregjeve të energjisë, fuqizimi i konsumatorëve dhe roli i komunikimit efektiv në nxitjen e tranzicionit energjitik.

Z. Hasan OZKOC, Drejtues i Sekretariatit në MEDREG, theksoi rëndësinë e takimeve të tilla për shkëmbimin e njohurive midis rajoneve fqinjë.

Në sesionin e dytë, znj. Erjola Sadushi, Komisionere e Bordit të ERE-s gjatë fjalës së saj si pjesë e panelit, theksoi rolin kyç të fuqizimit të konsumatorëve në ofrimin e fleksibilitetit për rrjetin, një faktor me rëndësi në avancimin e tranzicionit energjitik.

Workshopi u pasua dhe nga raste studimore dhe prespektiva të vendeve të tjera të rajonit. Për të ndjekur aktivitetin e plotë ju ftojmë të vizitoni faqen zyrtare të [#medreg](https://twitter.com/medreg).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Forumi "Dinamika e Gazit në Peizazhin e Tranzicionit të Energjisë në Zhvillim"

U zhvillua në datat 14 - 18 tetor 2024, Forumi i titulluar "Dinamika e Gazit në Peizazhin e Tranzicionit të Energjisë në Zhvillim" bashkë - organizuar nga Forum i Gazit Mesdhetar Lindor - EMGF dhe Unioni Ndërkombëtar i Gazit, si dhe seminari i Këshillit të IGU 2024 i cili u fokusua në "Ekonominë e hidrogjenit - Egjipti dhe ndryshimi global i energjisë së pastër". Ky aktivitet i përvitshëm u mikëprit këtë herë nga Shoqata Egjiptiane e Gazit në Kairo, dhe ofron një shans të vlefshëm për t'u angazhuar me liderët e industrisë mbi rolin kritik të gazit në tranzicionin energjetik si dhe eksplorimin e të ardhmes së hidrogjenit në tranzicionin e energjisë së pastër. Pjesmarrës nga Enti Rregullator i Energjisë janë Komisioneri z.Maksim Shuli, si dhe Drejtori i Drejtorisë së Gazit Natyror, z. Gerti Bitri. Për më shumë ju ftojmë të shfletoni faqen zyrtare të #IGU <https://www.igu.org/>



Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike

Enti Rregullator i Energjisë dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike nënshkruan më 29 tetor 2024, një marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të sigurisë kibernetike, një hap ky i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për mbarëvajtjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit energjetik. Kjo marrëveshje është pikënisja e një punë të përbashkët në shkëmbimin e informacionit në kohë reale, parandalimin e sulmeve kibernetike, por dhe zhvillimin e mëtejshëm të trajnimeve dhe seminareve për shkëmbimin e eksperiencave në fushën e sigurisë kibernetike. ERE dhe ASKS synojnë nëpërmjet këtij bashkëpunimi, të sigurojnë një sektor energjetik të mbrojtur dhe të sigurtë.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Takimi i Presidentëve të vendeve anëtare të ERRA, zhvilluar në Tiranë nën mikëpritjen e ERE

Enti Rregullator i Energjisë mirëpriti më datë 28 tetor në Tiranë, Takimin e përvitshëm të Presidentëve të ERRA - Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë. Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i ERE z. Petrit Ahmeti, rikujtoi themelimin e ERRA 24 vite më parë, ku ERE ka qënë një ndër themeluesit dhe përgëzoi rritjen e saj në ditës e sotme me 23 anëtarë dhe 13 observues, të cilët shkëmbejnë eksperiencat e tyre në aktivitete të ndryshme që shërbejnë për rritjen e kapaciteteve formuese të rregullatoreve.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave lehtësojnë rrugën drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta, theksoi ndër të tjera z.Ahmeti, për zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm dhe tranzicionit energjetik. Temat në fokus gjatë takimit të sotëm ishin infrastruktura e rrjetit për përthithjen e energjisë së rinovueshme dhe siguria kibernetike në sektorin energjetik, faktorë mjaft të rëndësishëm. Ky aktivitet u pasua dhe nga takime dhe trajnime të ndryshme të pjesëmarrësve në ditët që pasuan.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me RAAEY

Ndër vite, bashkëpunimi mes Entit Rregullator të Energjisë dhe RAAEY - Autoriteti Rregullator për Energjinë, Mbeturinat dhe Ujin të Republikës së Greqisë, ka qënë frytdhënës në shkëmbimin e eksperiencave dhe koordinimin e nevojshëm të veprimeve në lidhje me çështjet me interes të secilës palë, veçanërisht brenda organeve ndërkombëtare të Shoqatës së Rregullatorëve të Energjisë Mesdhetare (MEDREG), Komunitetit të Energjisë (KE) dhe Shkollës Ballkanike të Energjisë (BES). Ky bashkëpunim u formalizua më 29 tetor 2024 nëpërmjet një Memorandumi Bashkëpunimi të nënshkruar nga të dyja palët, me qëllimin e përbashkët për të garantuar një treg energjie konkurrues, të sigurt dhe të

qëndrueshëm, për të promovuar një treg efektiv që funksionon për të gjithë pjesëmarrësit dhe për të siguruar kushte të përshtatshme për funksionimin efektiv dhe të besueshëm të rrjeteve, duke marrë parasysh objektivat afatgjata kombëtare dhe të Bashkimit Evropian.



Working Group i ERRA për gazin natyror

Në datat 28 - 29 tetor në ambjentet e Entit Rregullator të Energjisë u zhvillua takimi i Grupit të Punës së anëtarëve të ERRA për gazin natyror. Gjatë këtij takimi, vendet anëtare përditësuan pjesëmarrësit mbi lajmet dhe infrastrukturën e gazit, u diskutua mbi kuantifikimin e emetimeve të metanit, mbi ripërdorimin e infrastrukturës së gazit si dhe mbi rreziqet e sigurisë së furnizimit me gaz. Pjesëmarrësit gjithashtu u njohën me disa studime rasti si dhe me rezultatet e anketës së ERRA-s për Sigurinë Kibernetike në këtë sektor.

Platforma e krahasimit të energjisë elektrike PCT është një mjet që ju lejon të krahasoni ofertat për çmimin e energjisë elektrike nga furnizues të ndryshëm në tregun e lirë.

PCT
ALBANIA